



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 209, Datë 27.09.2018

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “AEE” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK “PLUG” ME FUQI TË INSTALUAR 2 MW ME VENDNDODHJE NË BASHKIA LUSHNJE, QARKU FIER

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”; nenit 5, pika 1 gërma “a”, dhe nenit 13 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016; dhe nenit 15 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 27.09.2018 mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë “AEE” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Plug” me fuqi të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Bashkia Lushnje, Qarku Fier

Konstatoi se:

- Bordi i ERE me vendimin nr. 191, datë 30.08.2018, ka filluar procedurën për licencimin e shoqërisë “AEE” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Plug” me fuqi të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Bashkia Lushnje, Qarku Fier
- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE me shkresën nr. 55/56 Prot., datë 30.08.2018, ka bërë njoftimin në median e shkruar si dhe me shkresën nr. 549/1 Prot., datë 03.09.2018 ka përcjellë pranë subjektit njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës si dhe mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:
 - Nenin 9, pika 4.4.5, gërma ‘a’, (Miratimin e OST ose OSHEE për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes).

- Shoqëria “AEE” shpk, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 549/2 Prot. datë 10.09.2018, ka plotësuar dokumentacionin e sipërcituar duke përcjellë Miratimin e OSHEE nr. 13870/1 Prot., datë 02.06.2017, për pikën e lidhjes së centralit fotovoltaik.
- Aplikimi i shoqërisë “AEE” shpk, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në *“Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”* si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3, 4.4.4 dhe 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Subjekti “AEE” sh.p.k., ka marrë Miratimin Përfundimtar nga MIE për një afat 49 vjeçar, por nga ana tjetër ERE në zbatim të nenit 38 të Ligjit “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 5 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet. Por duke qënë se nga Studimi i Fizibilitetit të paraqitur nga subjekti për centralin fotovoltaik “Plug”, rezulton se jetëgjatësia e panelit shkon deri më 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi të ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “AEE” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik “Plug” me fuqi të instaluar 2MW, me vendndodhje në Bashkia Lushnje, Qarku Fier, për një afat 25 (njëzet e pesë) vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI